

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS në seancën e panelit të përbërë nga gjykatësit ndërkombëtar Tudor Pantiru si kryetar paneli, gjykatësit profesional Lolita Dumlao dhe Christoph Von Feilitzsch, si anëtarë paneli me bashkëpunëtorin profesional Suad Kuraja si procesmbajtës në rastin penal C. 66/2001, kundër të akuzuarit Sava Matic nga Rahoveci, të ngarkuar me veprën penale për Krime Lufte Kundër Popullatës Civile sipas nenit 142 i Ligjit Penal të Jugosllavisë, akuzë e përmbajtur në Aktakuzën e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren CC nr. 310/99, të 11 shtatorit 2000, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit Publik të Qarkut CC nr. 310/99 të datës 20.04.2002 të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, C. Nr. 66/2001 të datës 27 mars 2002 dhe mendimit të Prokurorit Publik të Kosovës PPA. Nr. 174/2002 të darës 26 shkurt 2003,

në seancën e mbajtur sot, 14 prill 2003, bazuar në nenin 383 të LPP mori këtë

VENDIM

Ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, CC nr. 310/99 të datës 20.04.2002 të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, C. Nr. 66/2001 të datës 27 mars 2002, HEDHET POSHTË si e papranueshme.

ARSYETIMI

Prokuroria Publike e Qarkut në Prizren me 29 prill 2002 parashtrroi ankesë CC nr. 310/99 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, me të cilin i akuzuari Sava Matic ishte liruar nga akuzat për Krime Lufte Kundër Popullatës Civile, siç paraqitej në Aktakuzën CC nr. 310/99, të 11 shtatorit 2000. Prokurori i Qarkut propozon që Gjykata Supreme të revokon aktgjykimin e atakuar dhe ta kthej rastin te gjykata e shkallës së parë për rigjykim.

Prokurori Publik i Kosovës përkitazi me ankesën e parashtruar nga Prokurori Publik i Qarkut në Prizren me 26 shkurt 2003, prezantoi opinionin me shkrim në të cilin ai deklaroi se ankesa e prokurorit publik të qarkut në Prizren të refuzohet dhe se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të confirmohet.

Në seancën a panelit të Gjykatës Supreme të mbajtur me 14 prill 2003, Prokurori Publik i Kosovës sqaroi opinionin e tij me shkrim të datës 26 shkurt 2003 dhe deklaroi se me përdorimin e të drejtës së tij bazuar në nenin 361 par. 2 të Ligjit mbi Procedurën Penale të lexuar me nenin 8 të Ligjit mbi Prokurorinë Publike (Gazeta Zyrtare e KSAK, nr. 32/76), ai hiqte dorë nga ankesa e paraqitur nga Prokurori Publik i Qarkut në Prizren.

Andaj, Gjykata Supreme në pajtim me nenin 383 të Ligjit mbi Procedurën Penale mori vendimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

174/02

AP Nr. 14/2002 i datës 1 prill 2003

Procesmbajtësi
Suad Kuraja

Kryetari i panelit
Tudor Pantiru